



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

---

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike  
Mbledhja nr. 13  
Prishtinë, më 21.2.2018, në orën 13:30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

**Procesverbal**

**Në mbledhje morën pjesë:** Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Dragusha dhe Sergjan Mitroviç.

**Mungoi:** Zafir Berisha.

**Pjesëmarrësit e tjerë:** Ali Lajçi, Sami Kurteshi, Fitore Pacolli- deputetë; Agnesa Haxhiu, Albert Krasniqi-KDI; Berita Abazi-LVV; Naim Jakaj-këshilltar; Egnesa Vitia-praktikante; Vlora Nushi OPA/UNMI; Adem Gashi, Emma Lomax-Ambasada Amerikane; Blerta Bejtullahu EUSR/EU Office; Nehat Dervishi-OSBE; Besiana Bajrami-EO; Shefki Kastrati-NDI dhe media.

**Nga stafi i komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

**Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.**

**Vjosa Osmani-Sadriu**, theksoi se për këtë takim është paraparë shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Projektligji paraprak, i cili ishte shqyrtuar në komision, tha se është tërhequr nga Qeveria dhe është proceduar një projektligj tjetër i ri, i cili ka përfshirë edhe një deklaratë të përbashkët, të nënshkruar nga Presidenti i Kosovës dhe ai i Malit të Zi, që është pjesë e projektligjit. Komisioni është deklaruar lidhur me përmbajtjen e projektligjit të mëparshëm, por nuk është deklaruar për deklaratën e re, e cila i është bashkëngjitur projektligjit. Ky projektligj, tani i është proceduar komisionit, që pas shqyrtimit të tij të procedohet në mbledhje plenare të Kuvendit.

**Visar Ymeri**, tha se ajo që është cekur disa herë në komision, lidhur me këtë projektligj, tani me këtë marrëveshje në mes të dy presidentëve, po konfirmohen kritikant, të cilat janë diskutuar dhe që kanë dalë nga raporti i Komisionit Shtetëror, të kryesuar nga z.Bulliqi, për

tejkalim e kompetencave të ish-Komisionit Shtetëror. Propozoi që kjo marrëveshje, në këtë formë, të mos i procedohet Kuvendit për miratim, fare. Më tej, theksoi se argumenti i fundit, në fakt, nuk është kurrfarë rregullimi i çështjes, por vetëm pranim i humbjes së territorit që ka qenë nga viti 2015. Marrëveshja e re, në mes të dy presidentëve, tha se nuk e ka kuptimin e njëjtë për të dyja palët. Në njëërën anë pretendohet nga Qeveria e Kosovës se do ta korrektojë ish- marrëveshjen, për ta pamundësuar humbjen e territorit, ndërsa pala malazeze thekson se do të ketë korrektime, sepse në secilin proces të shënjimit të vijës kufitare ka korrektime, bazuar në rrethanat e relievit dhe kushteve të tjera në terren, në të cilin shënohet, tha z. Ymeri. Procesi i demarkimit, gjithnjë mund të ketë edhe korrektime, por jo në atë nivel të madh sa për ta kthyer atë sipërfaqe që ka qenë pjesë e Republikës së Kosovës, tha ai. Z. Ymeri theksoi se do të votojë kundër kësaj marrëveshjeje, dhe si e tillë, nuk do të duhej t'i procedohej fare Kuvendit.

**Dukagjin Gorani**, lidhur me deklaratën e përbashkët në mes të dy presidentëve, tha se edhe pse mund të interpretohet si një përpjekje për ratifikim të marrëveshjes, megjithatë është përpjekje që një dëm të mbulohet me një improvizim. Z. Gorani, në mes tjerash, tha se e pengon përpjekja e pushtetit që një marrëveshje të dëmshme, të mos e pranojë si të tillë. Kjo marrëveshje i ka bërë vendit dëm të pariparueshëm dhe së paku pranimi i atij dëmi do të hapte rrugë për një diskutim normal dhe të sigurtë. Më tek, theksoi se tani çështja e demarkacionit ka dalë nga kornizat teknike dhe është shndërruar në kauzë politike.

**Elmi Reçica**, duke vënë në pah se Kosova me Malin e Zi kanë qenë në një shtet të përbashkët, theksoi se në momentin kur ne kërkojmë kufi natyror dhe kufi shtetëror të kohës së kaluar, në këtë kohë, gabojmë. Republika e Malit të Zi ka dëshmuar se është shtet aleat i Kosovës dhe e ka mbështetur Kosovën, në të gjitha proceset. Beteja për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, tha se ka qenë betejë argumentesh dhe marrëveshja në mes të dy presidentëve ka dhënë mundësinë dhe rastin që të ofrojmë argumente për ta ndarë kufirin me Malin e Zi. Deklarata në mes të presidentëve ka pasur një jehonë pozitive te qytetarët e Kosovës dhe se demarkacioni i kufirit kësaj radhe do të kalojë dhe do të plotësohet kushti më qenësor që ka Kosova, karshi BE-së, për liberalizimin e vizave. Z. Reçica propozoi që projektligji të votohet në komision e Kuvend, ngase tani ekziston një argument shtesë.

**Time Kadrijaj**, theksoi se është mirë që procedura ka arritur në këtë pikë që marrëveshja të votohet me deklaratën në mes të dy presidentëve dhe raportin e komisionit, të udhëhequr nga z. Bulliqi. Nëse kjo marrëveshje do të vinte pa këto dy dokumente, nuk do ta votonim, duke shtuar se tani është bërë një punë e mirë dhe se projektligji duhet të votohet nga të gjithë.

**Sami Kurteshi**, tha projektligji në thelb përmban pika kundërshtuese me njëra-tjetrën. Si i tillë, kërkon ratifikimin e një marrëveshjeje që nuk ka ndryshuar asgjë, as në përmbajtje e as në formë. Në nenin 3 të projektligjit, paragrafi 1.2, thuhet se pjesë përbërëse e tij është dokumentacioni zyrtar i Komisionit Shtetëror për Shënjimin e Kufirit Shtetëror. Ky projektligj, në njëërën anë kërkon ratifikimin e një marrëveshjeje që nuk ka ndryshuar fare dhe është bërë politikë për gati tre vite, ndërsa në anën tjetër, përmban një dokument që kundërshton plotësisht këtë marrëveshje. Sa i përket deklaratës së dy presidentëve, tha se ajo mund të jetë për përdorim të brendshëm, por sipas Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, kjo deklaratë nuk e obligon askënd. Ai përmendi se sipas Komisionit të Badinterit të vitit 1992, është vënë një parim, sipas të cilit kufijtë ekzistues pranohen si të tillë, ndërsa Komisioni Shtetëror e ka thyer këtë parim dhe ka përcaktuar kufij të rinj. Ky projektligj përmban kundërthënie të papajftueshme mes vete dhe duhet ta kenë parasysh të gjithë se marrëveshja si e tillë, është e dëmshme dhe e prek integritetin territorial të vendit.

**Ali Lajçi**, lidhur me projektligjin, tha se nuk kemi dilemë se është plotësisht i gabuar dhe se kjo vijë kufitare e quajtur demarkim, nuk është demarkim por është demilitim që do të thotë vendosje e një vije të re kufitare. Ai tha se ne e dimë historikun, se cila është krijesa e viteve '45 e '46, konfigurimin strukturor e juridik në ish-Jugosllavi dhe sipas komisionit për definimin e kufirit, kryetar i të cilit ishte Milorad Gjillasi, askush nuk mund dhe nuk ka mandat të bëjë vijë tjetër kufitare, pos asaj, sepse do të dilte demilitim dhe njëkohësisht tentim për ta bërë demarkimin e asaj vije të re, që është i papranueshëm dhe ka mbetur i papranueshëm te ne. Tani, ky është një kapitull, për të thënë në mënyrë shumë perfide, se është vërejtur gabimi për dy pika, në mënyrë që të miratohet projekti bazë i vitit 2015, i qeverisë së atëhershme.

Ai tha se kufijtë lëvizin sipas relievit dhe do të krijohet një komision teknik miks, i cili do t'i bëjë ato vija kufitare sipas projektligjit, por jo sipas raportit të komisionit, të kryesuar nga z. Bulliqi. Këto raporte dhe kjo deklaratë nuk do të kenë implikime dhe nuk prodhojnë përgjegjësi në aspektin juridik për Malin e Zi. Z. Lajçi, tha se ne jemi kundër miratimit të këtij projektligji dhe se është mirë që të mendohet për peshën politike të vendit.

**Fitore Pacolli**, tha se miratimi i këtij projektligji ka për qëllim shtyrjen përpara të synimit për liberalizimin e vizave të qytetarëve të Kosovës. Ne e dimë, tha znj. Pacolli, se kusht thelbësor për liberalizimin e vizave është luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe në këtë drejtim, Republika e Kosovës nuk ka bërë asnjë hap pozitiv. Kushti i luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar po vë në pah dhe po theksohet çdo ditë e më tepër nga politikanët evropianë. Propozoi që ky projektligj, së pari të rishikohet, të përmirësohen gabimet e bëra dhe të kemi një marrëveshje, e cila e mbron territorin e Republikës së Kosovës.

**Vjosa Osmani- Sadriu**, lidhur me projektligjin, tha se komisioni ka për detyrë që këtë projektligj ta procedojë më tej, për shqyrtim. Ajo hodhi në votim propozimin që Projektligji nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, të procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

#### *Përfundim*

Projektligji nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim.

(Me rastin e votimit në mbledhje ishin të pranishëm 10 deputetë, nga të cilët 4 vota ishin "për", 2 vota ishin "kundër" dhe 1 votë "abstenim". Tre (3) anëtarë të komisionit nuk iu nënshtruan procesit të votimit).

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetarja komisionit,

---

Vjosa Osmani-Sadriu